



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 10, datë 20.02.2017

Për

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.216, DATË 14.11.2000 PËR
“MIRATIMIN E SIMBOLEVE TË BASHKISË SË TIRANËS”**”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1.6, nenit 54, shkronja “l”, nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.14, datë 02.05.2012 për “Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës” dhe për një përfaqësimin dinjitoz dhe real të Bashkisë së Tiranës dhe të qytetarëve që ajo përfaqëson”,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet si më poshtë:

- (i) Stema e Bashkisë së Tiranës e parashikuar në kreun I, pika 1 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 216, datë 14.11.2000 (në vijim 216/2000) ristilizohet dhe ndryshon (sipas figurës nr.1 bashkëlidhur), pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- (ii) Flamuri i Bashkisë së Tiranës parashikuar në kreun I, pika 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 216/2000 ristilizohet dhe paraqet stemën e Bashkisë së Tiranës të përcaktuar sipas 1/(i), të këtij vendimi.
- (iii) Në Kreun I, pas pikës 3 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.216/2000 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“Stema e Bashkisë përdoret në të gjitha aktet (vendime, urdhra, urdhëresa, autorizime, kontrata, shkresa etj) e dala nga Bashkia e Tiranës”, sipas udhëzimeve të Manualit të Përdorimit të Logos, bashkëlidhur këtij vendimi si shtojca nr 1.

2. Ngarkohet aparati i Bashkisë së Tiranës, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

